




Projekte Vullnetare Ndërkombëtare

GUIDË PËR VULLNETARË





Jeni të interesuar të përfshiheni në vullnetarizëm?



Nuk dini ku të gjeni mundësi të ndryshme për të dhënë kontributin tuaj?



Në këtë guidë ju do të gjeni mundësi të ndryshme vullnetarizmi dhe udhëzime për mënyrën e aplikimit.



KONCEPTI I VULLNETARIZMIT

Termi **'vullnetarizëm'** përdoret për t'iu referuar një liste të plotë aktiviteteve që njerëzit ndërmarrin kur u japin ndihmë grupeve, shoqatave ose organizatave.

Ky aktivitet ka një ndikim të rëndësishëm në shoqëri, pasi është një **shprehje reale e qytetarisë aktive dhe demokracisë**, e cila përforcon disa nga vlerat themelore evropiane: **solidaritetin dhe kohezionin shoqëror**. Puna vullnetare nxit angazhimin, në shërbim të shoqërisë dhe nevojave të saj, ndihmon komunitetet e marginalizuara, fëmijët dhe të rinjtë në disavantazh ose grupe të ndryshme në nevojë.

Në përgjithësi dhe parimisht vullnetarizmi është praktika e kontributit të njerëzve, të cilët punojnë për të tjerët pa qenë të motivuar nga përfitimet financiare apo materiale.

Vullnetarizmi kryesisht lidhet me një **veprimtari altruiste**, që ka për qëllim promovimin e cilësisë më të lartë jetësore për njerëzit. Njerëzit po ashtu marrin pjesë në punë dhe aktivitete vullnetare **për të përfituar shkathtësi të reja** pa patur nevojën e investimeve financiare të punëdhënësit. Vullnetarizmi mund të ketë forma të ndryshme dhe ushtrohet nga grupe të ndryshme njerëzish.





LLOJET E VULLNETARIZMIT

01

Vullnetarizmi formal

- kontributin vullnetar të realizuar nën mbikëqyrjen e organizatave formale;
- i mirëplanifikuar dhe i strukturuar
- vullnetari vepron brenda strukturave dhe përmbush misionin e organizatës.

02

Vullnetarizmi joformal

- referohet një spektri të aktiviteteve vullnetare, që ndërmerren jashtë organizatave formale;
- njerëzit veprojnë si individë ose grupe për shembull, ndihma kundrejt një komuniteti të lagjes ose fetar,

03

Vullnetarizmi digjital

- i referohet vullnetarizmit nëpërmjet internetit dhe përdorimit të mjeteve dhe pajisjeve digjitale, gjithashtu i referohet si vullnetarizmi online apo vullnetarizmi virtual.

Llojet e projekteve e-vullnetare mund të jenë të ndryshme në varësi të tematikës së tyre dhe qëllimit që ato kanë për të ndihmuar një target grup të caktuar. Evullnetarët janë çelësi i suksesit në këto projekte, sepse pa bashkëpunimin e tyre nuk do të arrihej feedback-u që dëshirohet. Këta e-vullnetarë ndërmarrin role dhe përgjegjësi dhe angazhohen me kohë dhe gatishmëri të plotë, për të realizuar një sërë detyrash që caktohen.

Intership apo praktika pune konsiderohet një angazhim formal (i/papaguar), eksperiencë pune për të rritur aftësitë praktike si pjesë e studimeve apo kurseve që individi ndjek. Zakonisht ndihmon studentët për kalimin nga studimet në tregun e punës (periudhë tranzitore). Dhe ky term shpeshherë ngatërrohet me vullnetarizmin, edhe pse janë dy koncepte të ndryshme si praktikisht, ashtu dhe ligjërisht.



Projekte Vullnetare Ndërkombëtare

“ —

VULLNETARIZMI NË THELB ËSHTË KONTRIBUTI APO SHËRBIMI QË VENDOSIM TË JAPIM NË KOMUNITET ME VULLNET TË LIRË PA MARRË NJË SHPËRBLIM MONETAR NË KËMBIM.

POR CILAT JANË BENEFITET E VULLNETARIZMIT?

KRIJON
KONTAKTE TË
REJA

KRIJON
KOMUNITETE
TE FORTA
DHE
KOHEZIVE

PËRMIRËSON
MIRËQENIEN
FIZIKE DHE
EMOCIONALE

ZHVILLON
AFTËSITË PËR
JETËN (AFTËSITË
E BUTA)

ZHVILLON
MENDIMIN KRITIK

SJELL
LUMTURI NE
JETËN TUAJ

JU
PËRFORCON
VETËBESIMIN

PËRMIRËON
AFTËSITË
SOCIALE



VULLNETARIZMI NË BOTË

PËRMBLEDHJE

Që nga Viti Ndërkombëtar i Vullnetarizmit më 2001, më shumë se 70 ligje ose politika janë miratuar nga shtete të ndryshme. Pasi që lidhja mes vullnetarizmit dhe zhvillimit shoqëror, ekonomik dhe politik është bërë më e qartë, qeveritë shtetërore kanë avancuar drejt krijimit të mjediseve ligjore dhe rregullative brenda të cilëve vullnetarizmi mund të zhvillohet. Në këto ndërmarrje, qeveritë kanë treguar një kujdes të veçantë kontekstit vendor, traditave dhe kërkesave të komunitetit. Në Bashkimin Evropian, afërsisht 100 milion qytetarë të të gjitha moshave investojnë kohën, talentin dhe paratë e tyre, për të kontribuar pozitivisht në komunitet në organizata të shoqërisë civile, klube rinore, spitale, shkolla, etj.

Katër parime themelore janë vërejtur në këto praktika, të cilat në të shumtën e rasteve kanë qenë gjithëpërfshirëse, me pjesëmarrje **të qeverisë, shoqërisë civile, sektorit të biznesit dhe aktorëve të tjerë:**

- 1** Përcaktimi i qëllimeve themelore të një ligji ose politike mbi vullnetarizmin dhe i sfidave/pengesave të mundshme në arritjen e këtyre qëllimeve;
- 2** Aplikimi i një procesi pjesëmarrës dhe të hapur të analizës, hartimit dhe zbatimit;
- 3** Hartimi i ligjeve ose politikave për arritjen e qëllimeve të përcaktuara;
- 4** Sigurimi që ligjet ose politikat e reja janë duke u zbatuar në mënyrë efektive dhe të qëndrueshme.



VULLNETARIZMI NË RAJON

PËRMBLEDHJE

Një studim mbi shoqërinë civile në Evropën Qendrore dhe Lindore tregoi se shkalla e vullnetarizmit midis OShC-ve në Evropën Qendrore dhe Lindore është mjaft e ulët në vendet jo anëtare të BE-së, Mal të Zi (7.3%), Bosnje- Hercegovinë (7.9%), Kosovë (10.7%), Serbi (11.4%), Shqipëri (7.9%) (Meyer et al., 2016).

Kosovë

Indeksi i Shoqërisë Civile 2016 në Kosovë tregoi se 60 përqind e OShC-ve angazhojnë vullnetarë në punën e tyre.

Megjithatë, ndryshojnë llojet e angazhimit të vullnetarëve brenda OShC-ve. Ato kryhen nëpërmjet mënyrave formale dhe joformale.

Shqipëri

Në vitet e fundit ka pasur një interes të shtuar për aktivitetet vullnetare. Studimet tregojnë se të paktën një në pesë të rinj në Shqipëri është i angazhuar në punëvullnetare në ditët e sotme. Në Shqipëri, aktivitetet vullnetare organizohen kryesisht nga organizata të shoqërisë civile, të cilat bashkëpunojnë gjithashtu me institucionet shtetërore. OShC-të luajnë një rol të rëndësishëm në promovimin dhe menaxhimin e projekteve vullnetare.

Një studim i fundit i realizuar nga Rama dhe Xhaho (2020) mbi të rinjtë dhe vullnetarizmin në Shqipëri, nxori në pah se një pjesë e konsiderueshme e të anketuarve e kanë përjetuar vullnetarizmin si një **përvojë pozitive** dhe **përmbushëse**. Ky aktivitet perceptohet si një mundësi për të dhënë një kontribut për njerëzit dhe komunitetet në nevojë, pa ndonjë kompensim. Dy shpërblimet kryesore që perceptohet se përjeton njeriu nga kontributi vullnetar janë **përmirësimi i aftësive personale** dhe **profesionale**.

PROGRAMI I EUROPËS SOLIDARE



**EUROPEAN
SOLIDARITY
CORPS**

THE POWER OF TOGETHER.

European Solidarity Corps financohet dhe menaxhohet nga Komisioni Europian dhe portali i jep mundësinë të rinjve dhe organizatave që implementojnë projekte të gjejnë njëri-tjetrin. Këto projekte ofrojnë eksperiencë inspiruese dhe fuqizuese për të rinjtë, por gjithashtu sjellin ndryshime pozitive nëpërmjet zhvillimit të aftësive të ndryshme dhe kompetencave që fitohen gjatë procesit.



MË SHUME RRETH PROGRAMIT

- Në këtë program mund të marrin pjesë të rinjtë nga moshë 18-30 vjeç;
- Mund të jetë afatshkurtër (2 javë-2 muaj) ; afatgjatë (2 muaj-12 muaj);
- Mund të merrni pjesë vetëm një herë në jetë;
- Nëse zhvillon një program afatshkurtër në fillim, keni të drejtë të bëni dhe një afatgjatë; ndërsa e kundërta nuk është e mundur;
- Programi vullnetar mbulon të gjitha kostot e akomodimit, ushqimit, udhëtimit në vendin ku do të shkoni.
- Mund të merrni pjesë në projekte me tema të ndryshme si: mjedis, të drejtat e njeriut, migracion, çështje sociale etj.



KRITERET PËR TË MARRË PJESË

- Duhet të jeni resident në një nga vendet anëtare të BE-së ose vendet partnere si: Turqia etj;
- Niveli bazë i gjuhës angleze për të komunikuar
- Nuk kërkohet nivel akademik
- Motivim dhe dëshirë për të kontribuar në kauza të ndryshme
- Dëshirë për të njohur kulturën e reja



SI MUND TË APLIKONI?


- Duhet të regjistroheni në portal: https://youth.europa.eu/solidarity_en
- Pasi jeni regjistruar mund të eksploroni mundësitë që publikohen në portal;
- Zgjidhni një projekt;
- Dërgoni CV dhe letër motivimi;
- Intervistë të shkurtër me organizatën pritëse;
- Përgatitja e dokumenteve të nevojshme;
- Gati për një eksperiencë unike!



- Linku për të aplikuar: https://youth.europa.eu/solidarity_en
- Më shumë rreth programit:
<https://eusolidaritycorps.europa.org/mt/#home>
- Grupe në Facebook:
<https://m.facebook.com/groups/977442189056607/>
<https://m.facebook.com/groups/1147016848762453/>

LTV (Long-term volunteering) & Workcamps

SCI (Service Civil International), organizatë vullnetare e dedikuar të promovojë kulturën e paqes organizon projekte vullnetare afatshkurtra të njohura brenda SCI-së si 'workcamps' dhe projekte afatgjata (LTV). Këto projekte organizohen në bashkëpunim me organizatat e SCI-së që operojnë në shtete të ndryshme të botës dhe me organizatat partnere, të cilët krijojnë dhe organizojnë këto projekte bashkë me komunitetin lokal.



LTV (PROJEKTE AFATGJATA)

- Mund të behet disa herë ne jetë
- Shpenzimet janë të mbuluara
- Duhet të gjeni një organizatë të SCI-së në vendin tuaj
- Projekte nga temat më të ndryshme
- Mund të marrë pjesë cdo njeri 18+
- Klikoni më poshtë për të eksploruar projektet:



[Projekte Vullnetare Afatgjata](#)



WORKCAMPS (PROJEKTE AFATSHKURTRA)

- Mund të bëhet disa here në jetë
- Nuk ka limit moshe
- Shpenzimet janë të mbuluara përveç koston së udhëtimit
- Mund të kontribuoni në fusha të ndryshme
- Mund të aplikoni si individ ose me anë të një organizate të SCI-së
- Klikoni më poshtë për të eksploruar projektet:



[Workcamps](#)



Vullnetarizëm lokal

Vullnetarizmi lokal është komtributi i paçmueshëm që çdokush mund të japë në komunitetin e tij duke lënë një impakt të menjëhershëm. Në këtë mënyrë ju mund të bëni një ndryshim në komunitetin tuaj e njëkohësisht ky veprim do të ndikojë në përmirësimin e cilësisë së jetës tuaj nëpërmjet kohës produktive që kaloni, kënaqësisë shpirtërore, njohjes me njerëz të rinj etj.

Ka shumë organizata jo-qeveritare që ofrojnë mundësi vullnetarizmi në komunitetin tuaj.



PVN (PROJEKTE VULLNETARE NDËRKOMBËTARE)

Ofron mundësi vullnetarizmi:

- Pranë Bashkive
- Shkollave
- Qendrave Sociale
- Qendrave Komunitare




PVN Albania



Shkëmbime Rinore & Trajnime

Një mënyrë tjetër për tu angazhuar në projekte afatshkurtra janë shkëmbimet rinore dhe trajnimet. Këto trajnime trajtojnë tematikat nga më të ndryshmet duke përdorur metodat e edukimit joformal dhe që zhvillohen në vende të ndryshme të Europës.



SHKËMBIME RINORE & TRAJNIME

SALTO-YOUTH është një rrjet ndërkombëtar pjesë e Trajnimeve Strategjike të Komisionit European, i cili u ofron të rinjve resurse të edukimit jo-formal.

Më poshtë do të gjeni website të ndryshme ku mund të referoheni:



[Salto-Youth](#)



[Volunteer world](#)



[PVN Albania](#)



[SCI \(Service Civil International\)](#)



Shërbimi Civil

Shërbimi Civil është një program vullnetarizmi nisur nga qeveria franceze në vitin 2010 specifikisht për të rinjtë nga mosha 18-25 vjeç. Shërbimi Civil iu ofron të rinjve mundësinë për të marrë pjesë në një eksperience vullnetare në një organizatë në Francë ose jashtë saj për një periudhë 6-12 muaj për të kontribuar në arritjen e një misioni të caktuar që i shërben komunitetit. Ky program ka si qëllim rritjen personale dhe profesionale të të rinjve dhe promovimin e vlerave qytetare si: respekt, solidaritet, tolerancë etj.



SI MUND TE APLIKONI?



- Klikoni te faqja më poshtë për të eksploruar mundësitë
- Gjeni një mision/projekt që ju pershtatet
- Dërgoni aplikimin tuaj (nuk kërkohen kualifikime specifike)
- Do të merrni një email i cili konfirmon që aplikimi ka arritur me sukses
- Do të merrni një përgjigje brenda një muaji
- Pasi pranoheni, do të keni një takim me organizatën pritëse
- Firmosni kontratën
- GATI PËR AVENTURËN E RE!




Shërbimi Civil



KONTAKTE




PVN Albania



PVN Albania



pvnalbania.org



info@pvnalbania.org

— “ —

I slept and I dreamed that life is all
joy, I woke and I saw life is all
service, I served and I saw that
service is joy

— ” —

KAHLIL GIBRAN